

**STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE ME
OFERTË PRIVATE
ADRIATIC RESORTS SHA**

**STATUTE OF THE JOINT STOCK
COMPANY WITH PRIVATE OFFER
ADRIATIC RESORTS SHA**

Data 10-10-2022

Date 10-10-2022

KREU I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1.01 Përkufizimet

Fjalët e përdorura në këtë Statut me germa kapitale do të kenë kuptimin si më poshtë:

“Aksionari i Vetëm” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 3.01 (*Aksionarët*).

“Data e Nënshkrimit” është data në të cilën është nënshkruar ky Statut.

“Kontribut në Natyrë” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 6.02 (*Kontributet*).

“Legjislacion i Zbatueshëm” do të thotë çdo ligj, akt nënligjor, akt normativ kombëtar apo lokal, urdhër, dekret apo akt tjetër, kod, direktivë, vendime dhe akte të ministrave, qarkore të departamenteve, rregullore, deklarata dhe interpretime të organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, çdo vendim gjyqësor apo çdo licencë, aprovim, leje apo autorizim apo miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë, apo të çdo njësie apo ndarje administrative ose të çdo Personi të krijuar me ligj, (qoftë i pavaruar apo jo), që ka juridiksionin përkatës, përfshirë ndryshimet e herëpashershme të tyre.

“Ligji për Shoqëritë Tregtare” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

“Statuti” është statuti i Shoqërisë.

“Shoqëria” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 2.03 (*Emërtimi*) i këtij Statuti.

KREU II. ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 2.01 Organizimi

Aksionari i Vetëm miraton themelimin e një shoqërie aksionare me ofertë private, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, për qëllimet dhe brenda fushës së zbatimit të përcaktuar nga ky Statut. Aksionari i



CHAPTER I. GENERAL CLAUSES

Article 1.01 Definitions

The capitalized terms used in this Statute will have the following meaning:

“Sole Shareholder” has the meaning given in Article 3.01 (*Shareholders*).

“Signing Date” means the date when this Statute is signed.

“Contribution in Kind” has the meaning given in Article 6.02 (*Contributions*).

“Applicable Law” means any law, bylaw, national or local normative act, order, decree or other act, code, directive, decisions and acts of ministers, circulars of departments, regulations, statements and interpretations of official bodies of the Republic of Albania, any court decision or any license, approval, permit or authorization or other approvals in force, of the Republic of Albania, or of any administrative unit or division or of any Person created by law, (whether independent or not), having the relevant jurisdiction, including their occasional changes.

“Law on Companies” means Law No. 9901, dt. 14.04.2008 “On Entrepreneurs and Companies”, as amended.

“Statute” means the statute of the Company.

“Company” has the meaning given in Article 2.03 (*Name*).

CHAPTER II. ORGANIZATION OF THE COMPANY

Article 2.01 Organization

The Sole Shareholder approves the establishment of a joint stock company with a private offer, in accordance with the Law on Companies, for the purposes and within the scope of application



Vetëm do të paraqesë menjëherë dokumentet e nevojshme në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në lidhje me formimin dhe funksionimin e Shoqërisë, siç mund të kërkoet ose është e përshtatshme sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

Neni 2.02 Struktura e Shoqërisë

Shoqëria do të organizohet sipas sistemit të administrimit me dy nivele, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Organet e shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori.

Neni 2.03 Emërtimi

Emri i shoqërisë do të jetë Adriatic Resorts SHA ("Shoqëria"). Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin, nën çdo emër tjetër për të cilin është rënë dakord nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 2.04 Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

a. Veprimtaria në fushën e strukturave akomoduese. Ndërtimi, administrimi dhe shfrytëzimi i hoteleve me 5 yje, ushtrimi i veprimtarive të ligjshme në fushën e hotelerisë, shërbimeve të ofrimit të pijeve dhe ushqimit dhe turizmit si dhe çdo veprimtari tjetër në funksion të tyre.

b. Veprimtaria në fushën e lojërave të fatit. Ndërtimi, administrimi dhe shfrytëzimi i kazinove dhe ushtrimi i veprimtarive të ligjshme në fushën e lojërave të fatit.

c. Veprimtaria në sektorin e pasurive të paluajtshme. Ndërtimi, administrimi, shfrytëzimi dhe shitja e pasurive të paluajtshme.

d. Veprimtari të përgjithshme. Çdo aktivitet tjetër që lejohet nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2.05 Vendi i Ushtrimit të Veprimtarisë



determined by this Statute. The Sole Shareholder shall promptly file with the National Business Center the necessary documents relating to the formation and operation of the Company, as may be required or appropriate under the Applicable Law.

Article 2.02 Structure of the Company

The Company will be organized according to the two-tier model system, in accordance with the provisions of the Law on Companies. The bodies of the Company will be the General Assembly, the Supervisory Board and the Administrator.

Article 2.03 Name

The name of the Company will be Adriatic Resorts SHA (the "Company"). The Company may exercise its activity under any other name agreed upon by the General Assembly.

Article 2.04 Scope

The scope of the Company's activities will include the following operations:

a. Activity in the field of accommodation. Construction, administration and operation of 5-star hotels, the exercise of legal activities in the field of hotels, beverage and food services, and tourism and any other related activity.

b. Activity in the field of gambling. Construction, administration and operation of casinos and the exercise of legal activities in the field of gambling.

c. Activity in the field of real estate. Construction, administration, operation and sale of real estate.

d. General activity. Any other activity that is allowed by Albanian legislation.

Article 2.05 Registered Office



a. Selia. Selia e Shoqërisë do të jetë e vendosur në ABA Business Center, Rruga "Papa Gjon Pali II", Kati nr. 14, Zyra 1401, Tiranë, Shqipëri.

b. Email. Adresa e Shoqërisë për qëllime të komunikimit elektronik do të jetë info@ffconsulting.al

c. Faqja e Internetit. Faqja e Internetit të Shoqërisë do të jetë www.adriaticresorts.net.

Neni 2.06 Afati

a. Fillimi. Shoqëria do të fillojë veprimtarinë në datën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare Shqiptare të Biznesit, me kusht që të plotësohen kërkesat e themelimit të përcaktuara në Nenin 2.01 (*Organizimi*).

b. Kohëzgjatja. Kohëzgjatja e Shoqërisë do të vazhdojë për një kohë të pacaktuar, ose deri në prishjen e Shoqërisë në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, vendimeve të marra në bazë të tij, ose kur parashikohet nga Legjislacioni i Zbatueshëm.

KREU III. AKSIONARËT

Neni 3.01 Aksionarët

Shoqëria do të themelohet nga Adriatic Resorts Holding UK LIMITED, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe regjistruar sipas ligjeve të Anglisë dhe Uellsit, me numër identifikimi 14320966, me adresë në 140 Brompton Road, Knightsbridge, Londër, Mbretëri e Bashkuar ("Aksionari i Vetëm").

Neni 3.02 Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme do të jetë autoriteti më i lartë i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme do të drejtohet nga kryetari i Asamblesë së Përgjithshme, i cili emërohet në çdo mbledhje në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3.03 Njoftimet dhe Vendi i Mbledhjes



a. Headquarters. The registered office of the Company will be located in ABA Business Center, Street "Papa Gjon Pali II", Floor no. 14, Suite 1401, Tirana, Albania.

b. Email. The Company's address for electronic communication purposes will be info@ffconsulting.al

c. Website. The Company's website will be www.adriaticresorts.net.

Article 2.06 Deadline

a. Date of Registration. The company will start operating on the date of its registration in the Commercial Register of the Albanian National Business Center, provided that the establishment requirements set forth in Article 2.01 (*Organization*) are met.

b. Duration. The Company will exercise its activities indefinitely, or until the dissolution of the Company in accordance with the provisions of this Statute, the decisions based on it, or when provided by the Applicable Law.

CHAPTER III. SHAREHOLDERS

Article 3.01 Shareholders

The Company will be founded by Adriatic Resorts Holding UK LIMITED, a limited liability company incorporated and registered under the laws of England and Wales, with identification number 14320966, and located at 140 Brompton Road, Knightsbridge, London, United Kingdom ("Sole Shareholder").

Article 3.02 General Assembly

The General Assembly will be the highest authority of the Company. The General Assembly will be led by the chairman of the General Assembly, who is appointed at each meeting in accordance with the Law on Companies.

Article 3.03 Notifications and Meetings



a. Thirrja e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori.

b. Mënyra e njoftimit. Të gjitha njoftimet për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme do të kryhen sipas dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, me letër rekomandë, me faks ose e-mail, me kërkesë për konfirmim. Ky njoftim duhet të përcaktojë kohën, vendin, rendin e ditës, vendimet e propozuara së bashku me materialet mbështetëse si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

c. Vendi. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të mbahen në selinë e Shoqërisë.

Neni 3.04 Vendimarrja

Aksionari i Vetëm do të realizojë të gjithë të drejtat dhe do të përmbushë të gjithë detyrimet që rrjedhin nga Ligji për Shoqëritë Tregtare. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të Vetëm do të marrë vendimet e duhura për Shoqërinë dhe do të mandatojë administratorin e saj ose këdo person tjetër, sipas rastit, që të nënshkruajë dhe ekzekutojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

KREU IV. KËSHILLI MBIKËQYRËS

Neni 4.01 Përbërja dhe Autoriteti

a. Numri i anëtarëve. Në bazë të nenit 166 e në vijim të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, menaxhimi i Shoqërisë, pronës dhe çështjeve të Shoqërisë do të mbikëqyret nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë i përbërë nga 3 (tre) anëtarë ("Anëtarët"), njëri prej të cilëve do të shërbejë si Kryetar i Bordit ("Kryetari"). Anëtarët e emëruar dhe Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës përcaktohen në Shtojcën 1 të këtij Statuti.

b. Autoriteti. Anëtarët do të kenë kompetencën e përgjithshme për të mbikëqyruar veprimtarinë e Shoqërisë, brenda objektit të veprimtarisë të përcaktuar në Nenin 2.04 (Objekti) i këtij Statuti.

c. Afati. Çdo Anëtar do të zgjidhet për një mandat 3 (tre) vjeçar. Çdo Anëtar do të shërbejë derisa

a. Calling the Meeting. The General Assembly can be called by the Supervisory Board and the Administrator.

b. Method of Notification. All notifications for the call of the General Assembly will be made according to the provisions of the Law on Companies, by tracked letter, fax or e-mail, with a request for confirmation. This notice must specify the time, place, agenda, proposed decisions along with supporting materials as well as any other requirements derived from the Law on Companies.

c. Place. The meetings of the General Assembly will be held at the registered office of the Company.

Article 3.04 Decision-making

The Sole Shareholder will exercise all rights and fulfill all obligations arising from the Law on Companies. The General Assembly of the Sole Shareholder shall take the appropriate decisions for the Company and mandate its Administrator or any other person, as the case may be, to sign and execute the decisions of the General Assembly.

CHAPTER IV. SUPERVISORY BOARD

Article 4.01 Composition and Authority

a. Number of Members. Pursuant to Article 166 et seq. of the Law on Companies, the management of the Company, the property and the affairs of the Company will be supervised by the Supervisory Board of the Company consisting of 3 (three) members ("Members"), one of whom will serve as chairman of the board (the "Chairman"). The appointed members and the Chairman of the Supervisory Board are defined in Appendix 1 of this Statute.

b. Authority. The Members will have the general competence to supervise the activity of the Company, within its scope defined in Article 2.04 (*Scope*) of this Statute.

c. Deadline. Each Member shall be elected for a term of 3 (three) years. Each Member shall

ky Anëtar të japë dorëheqjen ose të shkarkohet në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

d. Shpërblimi. Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mund t'u jepet shpërblim. Nëse përcaktohet, një shpërblim i tillë do të jepet nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 4.02 Shkarkimi dhe Dorëheqja

a. Shkarkimi nga detyra. Një Anëtar mund të shkarkohet menjëherë nga detyra në çdo kohë për çfarëdo arsye.

b. Dorëheqja me njoftim me shkrim. Anëtari mund të japë dorëheqjen në çdo kohë duke njoftuar me shkrim Shoqërinë. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë njoftim, dorëheqja do të hyjë në fuqi pas marrjes së një njoftimi të tillë nga Shoqëria.

Neni 4.03 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

a. Thirrja e një mbledhjeje. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës thirren nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, sa herë që e gjykon të nevojshme për veprimtarinë e shoqërisë, por të paktën dy herë në vit, me iniciativën e tij ose me kërkesën e ndonjërit prej Anëtarëve. Nëse Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës nuk përmbush kërkesën e tillë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga kërkesa, secili Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtë të thërrasë drejtpërdrejt Këshillin Mbikëqyrës.

b. Periudha e Njoftimit. Këshilli Mbikëqyrës thirret me një afat njoftimi prej 10 (dhjetë) ditësh kalendarike me postë, faks, e-mail ose telefon. Njoftimet me e-mail ose telefon do të pasohen nga transmetimi me faks ose postë. Në raste urgjente, afati i njoftimit mund të shkurtohet, me kusht që të jenë njoftuar në mënyrë të vlefshme të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

c. Ora, Rendi i Ditës, Vendi. Ora, vendi i mbledhjes dhe rendi i ditës caktohen nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, me kusht që, megjithatë, nëse një mbledhje është thirrur nga një Anëtar në përputhje

serve until such Member resigns or is dismissed in accordance with the provisions of this Statute.

d. Remuneration. Members of the Supervisory Board may be remunerated. If so determined, such remuneration shall be granted by the General Assembly.

Article 4.02 Dismissal and Resignation

a. Dismissal. A Member may be immediately removed from office at any time for any reason.

b. Resignation by Written Notice. Members may resign at any time by notifying the Company in writing. Unless otherwise specified in such notice, resignation will be effective upon receipt of such notice by the Company.

Article 4.03 Meetings of the Supervisory Board

a. Calling the Meeting. Meetings of the Supervisory Board are called by the Chairman, whenever the Chairman deems it necessary for the Company's activity, but at least twice a year, on the Chairman's initiative or at the request of any of the Members. If the Chairman does not comply with such request within thirty (30) calendar days from the time of the request, each Member has the right to directly call the meeting.

b. Notification Period. The Supervisory Board is called with a notice period of 10 (ten) calendar days by mail, fax, e-mail or telephone. Notices by e-mail or telephone will be followed by fax transmission or mail. In urgent cases, the notice period may be shortened, provided that all Members have been duly notified.

c. Time, Agenda, Place. The time, place of the meeting and the agenda shall be determined by the Chairman, provided, however, that if a meeting is called by a Member in accordance with paragraph (a) above, the time, the place of the meeting and the agenda shall be determined by the Member calling the meeting. In case of an emergency, the place of

me paragrafin (a) më sipër, koha, vendi i mbledhjes dhe rendi i ditës vendoset nga anëtarë që thërret mbledhjen. Në rast urgjence, vendi do të jetë selia e regjistruar e Shoqërisë.

Neni 4.04 Kuorumi

Vendimet e Këshillit merren kur në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e Anëtarëve, me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Nëse numri i votave është i barabartë, atëherë vota e Kryetarit mbizotëron.

Neni 4.05 Kompetencat

Këshilli ushtron këto kompetenca:

- (i) Vëzhgon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori;
- (ii) Kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së Shoqërisë me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe të Statutit;
- (iii) Shqyrton dhe kontrollon librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e Shoqërisë;
- (iv) Miraton dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit dhe publikimit;
- (v) Ushtron çdo kompetencë tjetër të parashikuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm.

Neni 4.06 Procesverbalet e Takimeve

Kryetari do të sigurojë që të mbahet procesverbali i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës. Procesverbali duhet të përmbajë të paktën rendin e ditës, anëtarët e pranishëm, çështjet e diskutuara dhe argumentet e shkëmbyera ndërmjet anëtarëve gjatë mbledhjes, mendimin(et) kundërshtues të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe rezultatin e çdo votimi. Procesverbali i tillë nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe u vihet në dispozicion anëtarëve brenda një kohe

the meeting will be the registered office of the Company.

Article 4.04 Quorum

Decisions of the Supervisory Board are made when more than half of the Members are present at the meeting, with the majority of votes of the participants. If the number of votes is equal, then the Chairman's vote prevails.

Article 4.05 Powers

The Board shall have the following powers:

- (i) monitors and supervises the implementation of commercial policies by the Administrator;
- (ii) checks the compliance of the Company's activity with the requirements of the Law on Companies and the Statute;
- (iii) examines and verifies the accounting books, documents and assets of the Company;
- (iv) approves and signs the annual financial statements, activity progress reports, as well as other reporting and publication obligations;
- (v) exercises any other powers provided by the Applicable Law.

Article 4.06 Minutes of the Meetings

The Chairman will ensure that the minutes of the meetings of the Supervisory Board are kept. The minutes must contain at least the agenda, the Members present, the issues discussed, and the arguments exchanged between the Members during the meeting, the dissenting opinion(s) of the Members and the result of each vote. Such minutes are signed by the Chairman and made available to the

të arsyeshme pas mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës me postë, faks ose e-mail.

Neni 4.07 Mbledhjet e mbajtura në mënyrë telefonike

a. Mbajtja e takimeve. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës dhe mbledhjet e komiteteve mund të mbahen nëpërmjet përdorimit të video-telefonatave, video-platformave ose pajisjeve të ngjashme të komunikimit për sa kohë që të gjithë personat që marrin pjesë në një mbledhje të tillë mund të dëgjojnë njëri-tjetrin në kohën e një takimi të tillë. Pjesëmarrja në një mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës ose në mbledhjen e komiteteve sipas mjeteve elektronike të mësipërme do të njehsohet me praninë personalisht në një mbledhje të tillë.

b. Miratimi i rezolutave. Të gjitha rezolutat e Këshillit Mbikëqyrës mund të miratohen me shkrim (përfshirë faksin ose e-mailin) ose me konferencë telefonike, video-platformë ose pajisje të ngjashme komunikimi me kusht që asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të mos kundërshtojë me shkrim para miratimit të rezolutës.

c. Rezultatet e votimit. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës (ose mbajtësi i procesverbalit në emër të tij) do të bashkërendojë votimin dhe do t'u sigurojë anëtarëve rezultatit e votimit pa vonesa të panevojshme.

Neni 4.08 Rregullat Procedurale

Këshilli Mbikëqyrës do të miratojë rregullat procedurale për funksionimin e tij. Çdo ndryshim i kësaj rregullore do të kërkojë miratimin e Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 4.09 Komitetet

a. Krijimi dhe funksioni. Këshilli Mbikëqyrës mund të formojë komitete për detyra të veçanta ose në baza të përhershme të cilat do të kenë funksione këshilluese ose përgatitore. Ekzistenca e komiteteve nuk i heq autoritetin Këshillit Mbikëqyrës, i cili mbetet organi përgjegjës për vendimet që janë në kompetencat e tij.



Members within a reasonable time after the meeting of the Supervisory Board by mail, fax or e-mail.

Article 4.07 Meetings Held by Telephone

a. Holding the Meetings. Meetings of the Supervisory Board and meetings of committees may be held through the use of video calls, video platforms or similar communication devices as long as all persons participating in such meetings can hear each other. Participation in a meeting of the Supervisory Board or in the meeting of the committees according to the aforementioned electronic means will count as presence in-person at such meeting.

b. Adoption of Resolutions. All resolutions of the Supervisory Board may be passed in writing (including fax or e-mail) or through a conference call, video platform or similar communication devices, provided that no Member objects in writing before the resolution is passed.

c. Voting Results. The Chairman (or the record keeper on his behalf) will coordinate the voting and provide the Members with the result without undue delay.

Article 4.08 Procedural Rules

The Supervisory Board will approve the procedural rules for its operation. Any amendment to the rules will require the approval of the Supervisory Board.

Article 4.09 Committees

a. Creation and Function. The Supervisory Board may form committees for special tasks or on a permanent basis which will have advisory or preparatory functions. The existence of the committees does not remove the authority of the Supervisory Board, which remains the body responsible for taking decisions within its powers.

b. Procedural Rules. Unless expressly provided otherwise, the rules applicable to the



b. Rregullat Procedurale. Nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, rregullat e zbatueshme për Këshillin Mbikëqyrës, për aq sa është e mundur, do të zbatohen në mënyrë analoge për të gjitha komitetet e Këshillit Mbikëqyrës.

Supervisory Board shall, as far as possible, apply analogously to all its committees.

KREU V. ADMINISTRATORI

CHAPTER V. ADMINISTRATOR

Neni 5.01 Emërimi

Article 5.01 Appointment

a. Administratori i Parë. Shoqëria do të administrohet në aktivitetet e administrimit të zakonshëm nga Administratori. Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë Z. Steven Gallaway, shtetas amerikan, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal 982273693.

a. First Administrator. The Company will be administered in the ordinary course of its administration by the Administrator. The first Administrator of the Company will be Mr. Steven Gallaway, an American citizen, holder of ID number 982273693.

b. Mandati. Administratori emërohet për një periudhë kohore prej 3 (tre) vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

b. Mandate. The Administrator is appointed for a period of 3 (three) years, with the right to be reelected.

Neni 5.02 Shkarkimi dhe Dorëheqja

Article 5.02 Dismissal and Resignation

a. Shkarkimi. Çdo zyrtar i Shoqërisë, duke përfshirë Administratorin, mund të shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme në çdo kohë me ose pa shkak, sa herë që sipas gjykimit të Asamblesë së Përgjithshme do të përmbushen interesat më të mira të Shoqërisë.

a. Dismissal. Any official of the Company, including the Administrator, may be dismissed by the General Assembly at any time, with or without cause, whenever the General Assembly determines such dismissal to be in the best interests of the Company.

b. Dorëheqja. Administratori mund të japë dorëheqjen duke njoftuar me shkrim Asamblenë e Përgjithshme. Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë njoftim, dorëheqja do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit të tillë nga Asambleja e Përgjithshme dhe pranimi i dorëheqjes nuk do të jetë i nevojshëm për ta bërë atë efektive.

b. Resignation. The Administrator may resign by notifying the General Assembly in writing. Unless otherwise specified in this notice, the resignation shall be effective upon receipt of such notice by the General Assembly and acceptance of the resignation shall not be necessary to make it effective.

Neni 5.03 Kompetencat

Article 5.03 Powers

a. Përfaqësimi i Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet në marrëdhënien me të tretët nga Administratori.

a. Representation. The Company will be administered and represented in its relationship with third parties by the Administrator.

b. Menaxhimi i Shoqërisë. Administratori do të menaxhojë punët e përditshme të biznesit të Shoqërisë në përputhje me këtë Statut dhe parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

b. Management. The Administrator shall manage the daily business affairs of the Company in accordance with this Statute and the provisions of the Law on Companies.

KREU VI. KAPITALI

Neni 6.01 Kapitali Fillestar

a. Kapitali fillestar. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 3 500 000 lekë dhe është i ndarë në 100 aksione të zakonshme, me vlerë nominale 35 000 lekë secili.

b. Shlyerja e kapitalit fillestar. Aksionari do të shlyejë tërësisht kapitalin fillestar përpara regjistrimit.

Neni 6.02 Kontributet

Kontributi i aksionarëve mund të përbëhet nga para ose pasuri (pasuri e luajtshme ose e paluajtshme ose të drejta të shprehura në para ("Kontribut në natyrë")) Në rast të kontributeve në natyrë, nëse kërkohet nga ligji në fuqi, një ose më shumë ekspertë të pavarur të licencuar, të emëruar nga gjykata kompetente do të hartojnë një raport, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.


Neni 6.03 Regjistri i Aksioneve

Administratori është përgjegjës për krijimin dhe funksionimin e regjistrimit të aksioneve, i cili përmban emrin dhe mbiemrin e aksionarit, apo emrin e regjistruar, nëse është person juridik, vlerën nominale të aksionit, adresën e banimit apo zyrën qendrore të aksionarit dhe datën e kryerjes së regjistrimit, në përputhje me Nenin 119 të Ligjit.

Neni 6.04 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

a. Zmadhimi i Kapitalit. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë në bazë të Neneve 168-172 të Ligjit, me anë të emetimit të aksioneve të reja, zmadhimit të kufizuar të kapitalit, zmadhimit të autorizuar të kapitalit ose zmadhimit të kapitalit me aktive të Shoqërisë në bazë të kushteve të përcaktuara në Pjesën V, Titullin V, Kreret II, III, IV dhe V të Ligjit.

b. Zvogëlimi i Kapitalit. Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë nëpërmjet



CHAPTER VI. CAPITAL

Article 6.01 Initial Capital

a. Initial Capital. The registered capital of the Company is 3 500 000 ALL and is divided into 100 ordinary shares, with a nominal value of 35 000 ALL each.

b. Repayment of the Initial Capital. The Sole Shareholder will fully repay the initial capital before the registration of the Company.

Article 6.02 Contributions

The shareholders' contribution may consist of money or property (movable or immovable property or rights expressed in money ("Contribution in Kind")). In case of Contributions in Kind, if required by the Applicable Law, one or more licensed independent experts, appointed by the competent court will draft a report, in accordance with the provisions of the Law on Companies.


Article 6.03 Shares Register

The Administrator is responsible for the creation and operation of the shares register, which contains the name and surname of each shareholder, or the registered name, if it is a legal person, the nominal value of the share, the residential address or the central office of the shareholder and the date of registration, in accordance with Article 119 of the Law on Companies.

Article 6.04 Increase and Reduction of the Capital

a. Increase. The General Assembly may decide to increase the Company's capital based on Articles 168-172 of the Law, by means of issuing new shares, limited capital increase, authorized capital increase or capital increase with assets of the Company based on the conditions set forth in Part V, Title V, Chapters II, III, IV and V of the Law on Companies.

b. Reduction. The General Assembly may reduce the capital of the Company through the



zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve, zvogëlimit të thjeshtëzuar të kapitalit, apo anulimit të aksioneve në bazë të Neneve 181-186 të Ligjit me kusht që kapitali nuk mund të jetë më i vogël se kapitali i regjistruar i Shoqërisë.

Neni 6.05 Dividendi

a. Shpërndarja e Dividendit. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të shpërndajë dividendin dhe mund të vendosë në lidhje me fitimet që rezultojnë nga bilanci, pas zbritjes së rezervës ligjore dhe të gjithë shumave që Asambleja vendos si rezervë.

b. Deklarimi i Dividendit. Dividendi deklarohet dhe paguhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet për të cilët paguhet dividendi.

c. Rezervat Private. Asambleja mund të vendosë për krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore.

KREU VII. BUXHETI

Neni 7.01 Buxheti

a. Miratimi i Buxhetit. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para çdo viti fiskal, Administratori do t'i dorëzojë Këshillit Mbikëqyrës një buxhet të propozuar për vitin e ardhshëm fiskal, i cili do të jetë në formën dhe detajet e përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës. Sa më shpejt të jetë e mundur pas kësaj, por në çdo rast para fillimit të këtij viti fiskal, Administratori do t'i dorëzojë Këshillit Mbikëqyrës buxhetin e propozuar për çdo muaj kalendarik të atij viti fiskal. Ky buxhet i propozuar do t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu, buxheti i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës do t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.

b. Informacione të tjera financiare. Administratori gjithashtu do t'i paraqesë Këshillit Mbikëqyrës raporte të tjera (financiare ose jo) dhe

reduction of the nominal value of the shares, the simplified reduction of the capital, or the cancellation of the shares based on Articles 181-186 of the Law on Companies provided that the capital cannot be smaller than the registered capital of the Company.

Article 6.05 Dividend

a. Distribution of Dividend. The General Assembly may decide to distribute the dividend and may decide the amount of profits resulting from the balance sheet, after deducting the legal reserve and all amounts that the General Assembly establishes as a reserve.

b. Declaration of Dividend. The dividend is declared and paid in relation to the value of the registered capital representing the shares for which the dividend is paid.

c. Private Reserves. The General Assembly may decide on the creation of other reserves from the annual profits.

CHAPTER VII. BUDGET AND ACCOUNTING

Article 7.01 Budget

a. Approval of the Budget. Not later than 30 (thirty) days before each fiscal year, the Administrator shall submit to the Supervisory Board a proposed budget for the following fiscal year, which shall be in the form and detail determined by the Supervisory Board. As soon as possible, but in any case before the beginning of this fiscal year, the Administrator shall submit to the Supervisory Board the proposed budget for each calendar month of that fiscal year. This proposed budget will be subject to the review and approval of the Supervisory Board. Furthermore, the budget approved by the Supervisory Board will be subject to review and approval by the General Assembly.

b. Other financial information. The Administrator shall submit to the Supervisory Board such other reports (financial or otherwise) and

buxhete që Këshilli Mbikëqyrës mund të kërkojë herë pas here.

budgets as the Supervisory Board may request from time to time.

Neni 7.02 Librat e Shoqërisë dhe Përputhshmëria

Article 7.02 Books of the Company and Compliance

a. Librat dhe Dokumentet e Shoqërisë. Shoqëria do të mbajë ose do të bëjë që të mbahen librat dhe regjistrimet e duhura sipas Legjislacionit të Zbatueshëm në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë. Librat dhe dokumentet e Shoqërisë do të mbahen në çdo kohë në selinë ligjore të Kompanisë. Shoqëria do të mbajë në selinë e saj sa vijon:

a. Books and Documents of the Company. The Company shall keep proper books and records in accordance with the Applicable Law relating to the business of the Company. The books and documents of the Company shall at all times be kept at the registered office of the Company. The Company will maintain at its headquarters the following documents:

- (i) një kopje të këtij Statuti dhe të gjitha ndryshimet e tij;
- (ii) kopjet e deklaratave tatimore dhe raporteve të Shoqërisë, nëse ka, për tre (3) vitet më të fundit fiskale;
- (iii) kopjet e çdo pasqyre financiare, nëse ka, të Shoqërisë për pesë (5) vitet më të fundit fiskale; dhe
- (iv) dokumente të tjera në lidhje me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë që mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme herë pas here me vendim të Asamblesë së Përgjithshme ose Këshillit Mbikëqyrës.

- (vi) a copy of this Statute and all amendments thereto;
- (vii) copies of the Company's tax returns and reports, if any, for the most recent three (3) fiscal years;
- (viii) copies of any financial statements, if any, of the Company for the most recent five (5) fiscal years; and
- (ix) other documents related to the scope of the Company's activity that may be reasonably requested from time to time by a decision of the General Assembly or the Supervisory Board.

b. Pajtueshmëria. Shoqëria do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të marrë dhe mbajtur në fuqi dhe të për të zbatuar të gjitha miratimet, pëlqimet ose licencat e nevojshme për zhvillimin dhe përmbushjen e objektit të veprimtarisë.

b. Compliance. The Company shall use its best efforts to obtain and maintain in force and to enforce all approvals, consents or licenses necessary for the development and fulfillment of the scope of its activity.

Neni 7.03 Eksperti Kontabël

Article 7.03 Accounting Expert

Aksionari i Vetëm bie dakord të emërojë ekspertë të mirënjohur kombëtarë/ndërkombëtarë kontabël me qëllim të kryerjes së auditimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë në fund të vitit fiskal. Eksperti Kontabël fillestar do të jetë Ilir Daiu, i regjistruar si Person Fizik në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS L91310004 dhe me licence të lëshuar sipas vendimit të Komitetit të Regjistrimit nr. 361, datë 28.12.2015. Mandati do të jetë 1 (një) vjeçar.

The Sole Shareholder agrees to appoint well-known national/international accounting experts for the purpose of auditing the financial statements of the Company at the end of the fiscal year. The initial accounting expert will be Ilir Daiu, registered as a Natural Person at the Albanian National Business Centre, with NUIS L91310004, and with a license issued according to the decision of the Registration Committee no. 361, dated 28.12.2015. The term of the mandate shall be 1 (one) year

KREU VIII. TË NDRYSHME

CHAPTER VIII. MISCELLANOUS

Neni 8.01 Veçueshmëria

Termet, kushtet dhe dispozitat e këtij Statuti janë plotësisht të ndashme dhe vendimi ose aktgjykimi i çdo gjykate të juridiksionit kompetent që e bën të pavlefshëm ose të pazbatueshëm një ose më shumë nga këto kushte, kushte ose dispozita nuk do të bëjë të pavlefshëm ose të pazbatueshëm termet, kushtet ose dispozitat e këtij Statuti dhe një term i tillë i pavlefshëm ose i pazbatueshëm do të zëvendësohet me një term të vlefshëm dhe të zbatueshëm, i cili do të pasqyrojë në masën më të madhe të mundshme synimet origjinale të Aksionarit të Vetëm.

Neni 8.02 Legjislacioni i Zbatueshëm

Ky Statut në të gjitha aspektet do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Për atë që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat e ligjit për Shoqëritë Tregtare, të Kodit Civil Shqiptar, si dhe të çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8.03 Prishja dhe Likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë, mund të shpërndajë në dobi të aksionarit të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes.

Article 8.01 Severability

The terms, conditions and provisions of this Statute are fully severable and the decision or judgment of any court of competent jurisdiction that renders invalid or unenforceable one or more of these terms, conditions or provisions, shall not render invalid or unenforceable terms, conditions or provisions of this Statute and such invalid or unenforceable term shall be replaced by a valid and enforceable one which shall reflect to the greatest extent possible the original intentions of the Sole Shareholder.

Article 8.02 Applicable Law


This Statute in all aspects will be governed and interpreted in accordance with the laws of the Republic of Albania. To the extent not provided for in this Statute, the provisions of the Law on Companies, the Albanian Civil Code, as well as any other specific law in the Republic of Albania shall apply.

Article 8.03 Dissolution and Liquidation

In case of liquidation of the Company, the liquidator, in accordance with the Law on Companies and with the special decision of the General Assembly, may distribute all or part of the value of the Company's assets to the benefit of the shareholder and for this purpose, may assess any assets and determine the distribution method.


**NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
AKSIONARIT TË VETËM**

**ADMINISTRATORI
STEVEN GALLAWAY**

Steven M. Gallaway


**IN THE NAME AND FOR THE ACCOUNT OF
THE SOLE SHAREHOLDER**

**ADMINISTRATOR
STEVEN GALLAWAY**

Steven M. Gallaway



SHTOJCA 1

APPENDIX 1

TË DHËNAT E IDENTIFIKIMIT TË
ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËSIDENTIFICATION DATA OF THE
SUPERVISORY BOARD MEMBERS

1.	<p>Z. Christopher Mathew Rodelas, lindur më 18.09. 1985, shtetas amerikan, i identifikuar me pasaportën me nr. 655200441, me adresë: 3605 S. Town Center, Drive Las Vegas, NV 89135 USA.</p> <p>Afati i mandatit: Nga 10.10.2022-10.10.2025.</p> <p>Pozicioni: Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës</p>
2.	<p>Z. Lawrence Jay Weisman, lindur më 29.10.1969, shtetas amerikan, i identifikuar me pasaportën me nr. 510878012, me adresë: 3605 S. Toën Center, Drive Las Vegas, NV 89135 USA.</p> <p>Afati i mandatit: Nga 10.10.2022-10.10.2025.</p> <p>Pozicioni: Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës</p>
3.	<p>Z. Robert Lawrence Boughner, lindur më 21.01.1953, shtetas amerikan, i identifikuar me pasaportën me nr. 562283912, me adresë: 1 Hughes Center Dr. #503, Las Vegas, NV 89169 USA.</p> <p>Afati i mandatit: Nga 10.10.2022-10.10.2025.</p> <p>Pozicioni: Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës</p>

1.	<p>Mr. Christopher Mathew Rodelas, born on 18.09. 1985, American citizen, identified with passport no. 655200441, with address: 3605 S. Town Center, Drive Las Vegas, NV 89135 USA.</p> <p>Term of his mandate: From 10.10.2022 to 10.10.2025.</p> <p>Position: Member of the Supervisory Board</p>
2.	<p>Mr. Lawrence Jay Weisman, born on 29.10.1969, American citizen, identified with passport no. 510878012, with address: 3605 S. Town Center, Drive Las Vegas, NV 89135 USA.</p> <p>Term of his mandate: From 10.10.2022 to 10.10.2025.</p> <p>Position: Member of the Supervisory Board</p>
3.	<p>Mr. Robert Lawrence Boughner, born on 21.01.1953, American citizen, identified with passport nr. 562283912, with address: 1 Hughes Center Dr. #503, Las Vegas, NV 89169 USA.</p> <p>Term of his mandate: From 10.10.2022 to 10.10.2025.</p> <p>Position: Chairman of the Supervisory Board</p>




SHTOJCA 2

SPECIMEN I ADMINISTRATORIT

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'S. J.', with a long, sweeping underline that extends to the right.

APPENDIX 2

**SPECIMEN SIGNATURE OF THE
ADMINISTRATOR**

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'S. J.', with a long, sweeping underline that extends to the right.